



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-1293/1 të datës 22.02.2023, **HIDHET POSHTË.**

Denoncimi të dërgohet për veprim kompetent në Inspektoratin shtetërorë të punës së RMV-së

Lënda me numër 12-1293 të vitit 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1293/1 datë 22.02.2023 është formuar në bazë të denoncimit së dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për një procedurë të zbatuar në mënyrë të paligjshme për punësimin e /// me kohë të pacaktuar me kohë të plotë nga ana e personave zyrtarë në ///, pas një njoftimi publik të shpallur më parë, për të cilin aplikoi parashtruesi. Janë ngritur pretendime që kontestojnë vendimin e shkallës së parë për punësimin e një kandidati tjetër, për të cilin vendimi i shkallës së parë, thekson parashtruesi, pas ankesës së tij në Komisionin Shtetëror të Vendimmarrjes në Procedurat Administrative dhe Procedurat e Punësimit në Shkallën e Dytë ishte anuluar dhe lënda i është kthyer organit të shkallës së parë për rishqyrtim dhe vendimmarrje, në fazën e marrjes së vendimit për përzgjedhjen e kandidatit. Aty thuhet se kandidati i përzgjedhur ka dhënë informacion të pasaktë për kombësinë e tij. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë dorëzuar edhe provat – fotokopje e shpalljes publike dhe dy aktgjykime të gjykatës penale në lidhje me një ngjarje të ngjashme penalo-juridike.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent që është i autorizuar për hetimin e pretendimeve në pajtim me Ligjin është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e RMV-së, për të cilën denoncimi me provat do t'i dërgohet këtij organi për veprim kompetent.

Lidhur me pretendimet se kandidati i përzgjedhur ka dhënë të dhëna të rreme për kombësinë e tij, KSHPK-ja thekson se vërtetimi i kësaj gjendje nga shpalljet e punësimit në sektorin publik nuk është i rregulluar ligjërisht në RMV.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar në:

- Parashtruesi

- Inspektorati Shtetëror i Punës i RMV-së

Përpunoi Mr. D.D

Miratoi: N.B

**KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT**
Nënkryetar,
Katica Nikolovska

